BERISHA PRET NË TAKIM DR. DAVID HOSAFLOOK: ZBARDHI TË VËRTETËN HISTORIKE TË ROLIT TË PROTESTANTËVE NË SHQIPËRI

TAKIM ME DREJTORIN EKZEKUTIV TË INSTITUTIT PËR STUDIME SHQIPTARE DHE PROTESTANTE, DR. DAVID HOSAFLOOK

Më 12 gusht 2025, Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ish-Presidenti dhe dy herë Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Sali Berisha, pati kënaqësinë të mirëpriste në një takim miqësor Drejtorin Ekzekutiv të Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante, Dr. David Hosaflook. Ai i shprehu atij mirënjohjen e thellë për kontributin e vyer me studimet e tij të çmuara mbi historinë dhe kulturën shqiptare.

Gjatë bisedës u trajtua roli i lëvizjes protestante që nga koha e Perandorisë Osmane dhe ndikimi i saj në përhapjen e arsimit dhe të gjuhës shqipe, duke nisur nga shkolla e parë shqipe për vajza, e hapur në Korçë në vitin 1891.

Dr. Hosaflook ka dhënë një kontribut të veçantë në zbardhjen e të vërtetave historike mbi rolin e protestantëve në Shqipëri, veçanërisht me botimin e veprës *Lëvizja Protestante te shqiptarët, 1816–1908* dhe artikullin shkencor *Origjinat teologjike dhe gjeografike të protestantizmit në Shqipëri* (2018). Po ashtu, ai ka sjellë në anglishten bashkëkohore dy

vepra madhore: *Rrethimi i Shkodrës* të Marin Barletit dhe *Historia e Skënderbeut*, e cila ishte botuar për herë të parë në anglishten e vjetër, pwrkthyer nga frengjishtja, më 1596 nga Zacharia Jones. Sot këto libra janë të aksesueshëm për çdo anglishtfolës dhe studiues në mbarë botën.

Në këtë vizitë, Dr. Hosaflook solli edhe një koleksion librash të botuar nga Instituti i tij, si shenjë respekti dhe mirënjohjeje për mundësitë që iu dhanë për përhapjen e protestantizmit në Shqipëri që në vitet e para të vendosjes së demokracisë dhe të lejimit të ushtrimit të fesë pas periudhës së gjatë të ateizmit shtetëror.

Në bisedë u shkëmbyen gjithashtu mendime mbi interesin dhe aktivitetin e Presidentit Jimmy Carter për përhapjen e protestantizmit, si dhe mbi idetë dhe flijimin e Martin Luterit, i cili, për idealet e tij reformuese dhe luftën kundër korrupsionit, qëndroi i palëkundur deri në fund, edhe pse e dinte se e priste turrë drush.

Dr. Hosaflook shoqërohej nga ambasadori Mal Berisha, biografi i një prej figurave më të ndritura të protestantizmit dhe arsimit në Shqipëri – amerikanit Charles Telford Erickson – i cili ia kushtoi jetën e tij dhe të familjes kombit shqiptar. Pas pak ditësh, do të përkujtohet 100-vjetori i veprës së tij madhore: themelimi i Institutit Bujqësor Shqiptaro–Amerikan në Golem, që vazhdon të funksionojë edhe sot.

Dr. Hosaflook të impresionon gjithashtu me shqipen e tij të pastër, të pasur dhe të bukur.